

**STATUTI I**  
**SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE**  
**KUFIZUAR**  
**WOODLAND FURNITURE SHPK**

**Neni 1**  
**Ortakët/Themeluesit e Shoqerise**

1.1 **WOODLAND FURNITURE Shpk** themelohet nga:

- I. **Z. Bardhi Kurti**, shtetas shqiptar, lindur me 08.08.1964, mbajtes i ID me nr. 035965083, mbajtes i 1 (nje) kuote e cila perfaqeson 65% te kapitalit themeltar;
- II. **Z. Redjon Stasa**, shtetas shqiptar, lindur me 19.02.1990, mbajtes i ID me nr. 034343298, mbajtes i 1 (nje) kuote e cila perfaqeson 28% te kapitalit themeltar;
- III. **Z. Mark Tatej**, shtetas shqiptar, lindur me 21.01.1994, mbajtes i Pasaportes me nr. BE1950684, mbajtes i 1 (nje) kuote e cila perfaqeson 7% te kapitalit themeltar;

**Neni 2**  
**Emri i Shoqerise**

2.1 Emri i shoqerise eshte **WOODLAND FURNITURE SHPK** (ne vijim referuar si "Shoqeria").

**Neni 3**  
**Selia**

3.1 Selia e Shoqerise eshte ne adresen: "Rruga "Konferenca e Pezes", ish-porta kryesore Misto Mame, Zona Kadastrale 8240. nr pasurie 2070, Tirane".

3.2 Asambleja e Pergjithshme mund te transferoje seline ne nje adrese tjeter ne çdo kohe, ne perputhje me nevojat dhe interesat e Shoqerise.

3.3 Shoqeria mund te hape dege ose seli perfaqesimi ne Republiken e Shqiperise dhe/ose jashte vendit, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe procedurat e regjistrimit pas miratimit paraprak te Asamblese se Pergjithshme.

**Neni 4**  
**Forma Ligjore**

4.1 Shoqeria eshte themeluar dhe regjistruar ne perputhje me legjislacionin ne fuqi ne Republiken e Shqiperise dhe eshte formuar si Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar ("SHPK").

**Neni 5**  
**Kohezgjatja e Shoqerise**

5.1 Shoqeria eshte themeluar per nje periudhe te pakufizuar ne kohe.

**Neni 6**  
**Aktiviteti i Shoqerise**

6.1 Shoqeria eshte themeluar per kryerjen e veprimtarise ne vijim:


- Import, eksport te produkteve te gatshme prej druri, perpunim te lendes drusore per prodhimin e mobiljeve, karrikeve e orendive, gjysme produkte, elemente e detale druri te ndryshem, perpunim perfundimtar te mobiljeve, prodhim e perpunim te artikujve industriale e ushqimore, tregtimin e tyre me shumice e pakice, tregtimin e mallrave industriale e ushqimore si lende te para, veprimtari ne fushen e industrise mekanike qe lidhen me prodhimin, mirembajtjen dhe shitjen e teknologjive ushqimore e industriale duke hapur pika sherbimi per riparimin e tyre, transport per vete dhe per te trete si dhe cdo aktivitet tjeter qe lejohet nga legjislacioni ne fuqi.

6.2 Shoqeria mund te kryeje çdo biznes tjeter te ligjshem te lidhur direkt ose indirekt me aktivitetin kryesor, pa qene i percaktuar me pare, si dhe mund te shtoje apo zgjeroje aktivitetin e siperpermendur.

**KAPITALI THEMELTAR DHE KONTRIBUTET**

**Neni 7**  
**Kapitali Themeltar i Shoqerise**

7.1 Kapitali themeltar i Shoqerise do te jete **100'000 (njeqind mije) Leke** dhe do te perbehet nga 3



7.2 Kuotat e Shoqerise zoterohen sipas skemes se meposhtme:

- 1 (nje) kuote e cila perfaqeson **65 %** te kapitalit themeltar, zoterohet nga **Bardhi Kurti**
- 1 (nje) kuote e cila perfaqeson **28 %** te kapitalit themeltar, zoterohet nga **Redjon Stasa**
- 1 (nje) kuote e cila perfaqeson **7 %** te kapitalit themeltar, zoterohet nga **Mark Tatej**

7.3 Kuotat e Shoqerise jane te transferueshme nepermjet menyrove te parashikuara me ligj si shitblerje, dhurim, trashegimi, etj. Ne cdo rast transferimi duhet te kryhet me kontrate te shkruar.

7.4 Ne rast te transferimit te kuotes tek nje person i trete, me perjashtim te trashegimise, ky transferim do te jete i vlefshem nese Asambleja e Shoqerise e ka miratuar ate nepermjet nje vendimi te vecante.

7.5 Palet pranojne se transferimi i kuotes ne cfaredolloj forme ligjore, tek persona te trete, nuk mund te kryhet nese kuota nuk i eshte ofruar paraprakisht per blerje Ortakut tjetër, me nje cmim te arsyeshem (parablerja). Si kriter per percaktimin e cmimit te arsyeshem do te merret vlera qe ka kuota si dhe vlera qe ajo perfaqeson ne kapitalin e Shoqerise duke pasur parasysh pozicionin financiar te Shoqerise ne momentin e transferimit, asetet dhe detyrimet.

7.6 Ne rast te kalimit te kuotes per efekt trashegimie tek pasaardhesit e nje Ortaku, pasaardhesit e trashegojne kuoten me kete kufizim parablerje dhe ata nuk do te kene mundesi ta transferojne kuoten tek persona te trete, ne rast se nuk ja kane ofruar ate paraprakisht per blerje Ortakut tjetër, me nje cmim te arsyeshem.

## TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKUT

### Neni 8 Pergjegjesi te Kufizuara

8.1 Shoqeria eshte pergjegjese per detyrimet dhe borxhet e saj, duke perfshire te gjitha asetet e saj.

8.2 Secili prej Ortakeve garanton angazhimin e tij maksimal kundrejt Shoqerise, duke zbatuar rolin e ortakut ne menyre te tille qe interesi me i mire i Shoqerise te kete perparesi.

8.3 Palet do te bejne perpjekje te arsyeshme per shmangien e krijimit te situatave te konfliktit midis interesave te tyre personale dhe interesave te Shoqerise dhe nese situata te tilla krijohen pavaresisht vullnetit te tyre ata do t'i raportojne keto situata tek ortakët e tjere, jo me vone se 15 dite nga ndodhja e faktit.

8.4 Ne vleresimin e situatave te konfliktit te interesit do te merren parasysh parashikimet e nenit 13 te ligjit nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar.

8.5 Ne vleresimin e situatave te konfliktit te interesit do te merren parasysh jo vetem ortakët personalisht por edhe persona të lidhur me ta, ku "*persona te lidhur*" do te konsiderohen: të paralindurit apo të paslindurit, të afërmit në vijë të tërthortë të shkallës së dytë, birësuesi ose i birësuar, i afërmi i shkallës së parë i bashkëshortit/bashkëshortes; bashkejetuesi/ja, etj.

8.6 Secili prej Ortakeve merr persiper te mos angazhohet ne sipermarrje te tjera, ne cfaredolloj forme angazhimi, me objekt te njejte ose te ngjashem me objektin e aktivitetit te Shoqerise, duke mos i krijuar konkurrence asaj. Ky kufizim nuk zbatohet per angazhim te ortakeve si themelues apo pjesemarrje ne cdo forme, ne kompani me objekt te njejte ose te ngjashem, angazhim i cili eshte krijuar perpara dates se regjistrimit te Shoqerise.

8.7 Secili prej Ortakeve, pas dates se regjistrimit te Shoqerise, nuk duhet të krijojë një kompani, degë, zyrë përfaqësimi, ose të bëhet aksioner apo ortak dhe as të jetë anëtar i bordit drejtues, bordit mbikëqyrës, apo organeve të tjera drejtuese ne nje subjekt me aktivitet konkurrues pa një miratim me shkrim të dhënë paraprakisht nga Ortaku tjetër.

8.8 Ky parashikim nuk i ndalon Ortakët te angazhohen ne sipermarrje te tjera me objekt aktiviteti te ndryshem nga ai i Shoqerise.

8.9 Ky detyrim do te zbatohet nga Ortaku edhe pas largimit te tij nga Shoqeria, per nje periudhe 5-vjecare.

### Neni 9 Organet vendimarrrese te Shoqerise

Organet vendimarrrese te Shoqerise jane:

- Asambleja e Pergjithshme;
- Administratori(et).

## ASAMBLEJA E PERGJITHSHME E SHOQERISE

### Neni 10 Asambleja e Pergjithshme e Shoqerise

- a. amendimi dhe ndryshimi i Statutit të Shoqërisë;
- b. pranimi i ortakeve të rinj;
- c. bashkimi, ndarja, shpërberja dhe çdo transformim tjetër të Shoqërisë;
- d. miratimi i pasqyrave vjetore financiare të Shoqërisë dhe përdorimin e fitimit që rezultojn;
- e. emerimi dhe shkarkimi i Administratorit (ve) të Shoqërisë dhe zëvendësit e tyre, si dhe përcaktimin e shpërblimit të tyre për këto role;
- f. vendimi për shpërndarjen e fitimit të Shoqërisë;
- g. miratimi i rregulloreve të brendshme administrative të Shoqërisë;
- h. miratimi i buxhetit vjetor;
- i. miratimin e çështjeve të tjera për të cilat kjo e drejtë është e rezervuar për Asamblenë nga ligji dhe ky Statut;

10.2 Në çdo rast, Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë për çdo çështje tjetër të parashikuar nga ky Statut ose me ligj.

10.3 Mbledhjet e Asamblese së Përgjithshme drejtohen nga Kryetari i saj.

10.4 Kryetar i Asamblese së Përgjithshme do të jetë ortaku që mban kuotën e cila përfaqëson përqindjen më të madhe të kapitalit të Shoqërisë.

#### Neni 11

##### Thirrja e Asamblese së Përgjithshme

11.1 Asambleja e Përgjithshme do të mbledhet të pakten një herë brenda vitit të biznesit (mbledhja e zakonshme) si dhe në çdo rast tjetër të parashikuar në ligj.

11.2 Asambleja e Përgjithshme do të mbledhet me kerkese të Administratorit, me një njoftim të shkruar, të dërguar anëtarëve të Asamblese së Përgjithshme me anë të postës rekomandë ose postës elektronike të pakten 7 ditë para datës së mbledhjes. Njoftimi duhet të regjistrohet në procesverbalin e Shoqërisë.

Në rastin e njoftimit të mbledhjes në mënyrë elektronike, anëtarët e Asamblese së Përgjithshme duhet të konfirmojnë marrjen e e-mailit (njoftimit) brenda 1 dite pune nga dërgimi i këtij njoftimi.

11.3 Njoftimi për thirrjen e Asamblese së Përgjithshme duhet të përmbajë vendin, datën dhe orën e mbledhjes dhe rendin e ditës.

11.4 Në qoftë se të gjithë anëtarët janë të pranishëm në mbledhjen e Asamblese, vendimet merren në mënyrë të rregullt, edhe nëse kushtet e mesipërme formale nuk janë përmbushur.

11.5 Mbledhja e Asamblese së Përgjithshme mund të mbahet edhe me mjete të telekomunikimit në distancë si dhe mund të mbahet edhe në ndonjë vend tjetër përveç selisë së Shoqërisë, qoftë edhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

11.6 Ortaket janë përgjegjës për korrektesinë e adresave të komunikimit elektronik që i japin Administratorit si dhe për funksionimin normal të mjeteve të komunikimit elektronik në distancë që ata përdorin për të marrë pjesë në mbledhje.

11.7 Ortaket kanë detyrimin të informojnë në çdo kohë dhe jo më vonë se 5 ditë pune, në çdo rast kur adresa e tyre fizike apo adresa e tyre elektronike ndryshon, në të kundërt njoftimi quhet i kryer në adresën e vjetër.

#### Neni 12

##### Vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme

12.1 Vendimet e Asamblese së Përgjithshme do të miratohen me votim të hapur. Në rrethanat veçanta dhe për çështje të veçanta një vendim mund të miratohet me votim të fshehtë, në përputhje me dispozitat ligjore.

12.2 Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme me korrespondencë të shkruar, telekonferencë, video konferencë, ose me metoda të tjera të ngjashme.

12.3 Kuorumi i nevojshëm për të marrë vendime të vlefshme në Asamblenë e Përgjithshme është pjesëmarrja e ortakeve që përfaqësojnë së paku 40% të numrit të përgjithshëm të votave.

12.4 Në qoftë se Asambleja e Përgjithshme është mbledhur në mënyrë të rregullt, por kuorumi i kërkuar nuk arrihet, Asambleja do të mbledhet perseri. Thirrjet mbledhjeje e dytë perseri me të njëjtin rend dite, jo më vonë se 30 ditë.

12.5 Votimi i ¾ të të gjithë anëtarëve të Asamblese është i nevojshëm për të miratuar vendime në çështjet e mëposhtme:

- a. Ndryshimi i Statutit të Shoqërisë;
- b. Rritja ose zvogëlimi i kapitalit themeltar;
- c. Shpërndarja e fitimit;
- d. Riorganizimi ose shpërberja e Shoqërisë.

#### Neni 13

##### Procesverbali i Asamblese

13.1 Për çdo mbledhje të Asamblese së Përgjithshme, procesverbali për thirrjen e Asamblese dhe vendimet e marra duhet të regjistrohen. Një kopje e procesverbalit do të përgatitet për Shoqërinë si dhe një kopje për çdo anëtar të Asamblese së Përgjithshme.

pergjegjes per mbaqjen e procesverbaeve.

13.3 Kopjet e vendimeve te marra ne Asamble do t'u dorezohen anetareve te Asamblese me ane te postes rekomande ose postes elektronike.

## MENAXHIMI I SHOQERISE

### Neni 14 Administrimi i Shoqerise

14.1 Shoqeria mund te menaxhohet nga nje ose me shume administratore. Ne rast se do te kete me shume se nje administrator, Asambleja e Pergjithshme do te vendose me aktin e miratimit edhe nese ata do te kene te drejta te perbashketa apo te pavarura perfaqesimi.

14.2 Administratoret emerohen per nje mandat 5 vjeçar, te rinovueshem. Administratori i pare emerohet ne kete Statut.

14.3 Administrator(et) jane pergjegjes per organizimin e zakonshem dhe menaxhimin e aktivitetit te Shoqerise ne kuader te kompetencave te percaktuara ne vendimin per emerimin e tyre. Ata jane te autorizuar per te perfaqesuar Shoqerine ne lidhje me te gjitha çeshtjet qe lidhen me aktivitetin e Shoqerise ne kuader te kompetencave te dhena nga Asambleja e Pergjithshme.

14.4 Kompetencat dhe detyrimet e Administratoreve jane te bazuara ne ligj, ne kete Statut, vendimet e Asamblese dhe ne rregulloret e Shoqerise.

14.5 Kompetencat dhe pergjegjesite e Administratoreve jane si me poshte:

- a. per te perfaqesuar Shoqerine me palet e treta dhe autoritetet e tjera shtetore;
  - b. per te hapur, mbyllur dhe mirembajtur llogarite bankare dhe caktimin e nenshkruessve per llogarite bankare per Shoqerine;
  - c. per te lidhur marreveshje me palet e treta, per te nxjerre dhe marre urdherpagesat;
  - d. per te nenshkruar te gjitha dokumentet, leshurar faturat, transfertat ne monedhe te huaj, faturat doganore, etj, pagesat e detyrimeve te kompanise dhe pranimin e garancive nga palet e treta;
  - e. per te mbledhur detyrimet ne emer te Shoqerise;
  - f. per te nenshkruar kontratat e punes me punonjesit e Shoqerise, duke siguruar masat paraprake per mbrojtjen e interesit te Shoqerise;
  - g. per te depozituar pretendime, perfaqesuar dhe mbrojtur Shoqerine ne rast te pretendimeve kunder saj;
  - h. per te siguruar mbulimin e shpenzimeve e nevojshme qe lidhen me veprimtarine e zakonshme te Shoqerise;
  - i. per te siguruar se librat kontabel mbahen ne perputhje me ligjet ne fuqi ne Shqiperi;
  - j. per te siguruar pergatitjen e Pasqyrave Vjetore Financiare te Shoqerise;
  - k. per te thirrur Asamblene e Pergjithshme te zakonshme ose te jashtezakonshme, per te vendosur rendin e dites per mbledhje te tilla, per te monitoruar dhe trajtuar ekzekutimin e veprimeve te lidhura me mbajtjen dhe thirrjen e mbledhjeve te Asamblese se Pergjithshme, per te ndermarre veprimet e nevojshme per te njoftuar ortaket per vendime te veçanta dhe per te siguruar se te gjitha veprimet dhe njoftimet e tilla jane bere ne kohen e duhur;
  - l. per te mbajtur dhe per te ruajtur dokumentet e Shoqerise;
  - m. per te marre vendime per çeshtje te tjera qe lidhen me aktivitetin e brendshem te Shoqerise dhe marredheniet me te tretet;
  - n. per te marre cdo vendim tjeter per veprimtarine e zakonshme te Shoqerise, ne perputhje me legjislacionin, Statutin dhe interesin e Shoqerise.
- 14.6 Te gjitha veprimet e mesiperme mund te kryhen nga administratori personalisht ose duke emeruar perfaqesues te autorizuar.

### Neni 15 Emerimi i Administratorit

15.1 Administrator i Shoqerise eshte:


- **Znj. Mirela Angjeli**, shtetase shqiptare, lindur me 29.08.1968, mbajtese e ID me nr. 035816106.

*Specimeni i firmes se administratorit si me poshte:*

MIRELA ANGJELI 

15.2 Shoqeria eshte e lidhur nga marreveshjet e nenshkruara ne menyre te rregullt ne emer te Shoqerise nga administratori.

15.3 Administratori i Shoqerise mund te shkarkohet ne cdo kohe nga Asambleja e Pergjithshme.



## Neni 16

## Viti Financiar, Pasqyrat Financiare

16.1 Viti financiar i Shoqerise eshte periudha 12-mujore nga data 1 Janar deri me 31 Dhjetor te çdo viti. Viti i pare fiskal fillon nga data e regjistrimit te Shoqerise deri me 31 Dhjetor te atij viti.

16.2 Deri ne fund te çdo viti fiskal, administratorët do te kryejne detyrat e meposhtme:

- a. pergatitja e nje liste te detajuar te asetëve te Shoqerise dhe strukturese se tyre;
- b. pergatitja e bilancit, qe paraqet gjendjen financiare te Shoqerise;
- c. pergatitja e deklarates se fitimit dhe humbjes.

16.3 Pasqyrat financiare duhet te paraqiten per miratim ne mbledhjen e zakonshme te Asamblese se bashku me raportin nga auditorët e jashtem, nese ka, deri me 30 Qershor te vitit te ardhshem fiskal.

## Neni 17

## Fitimet e Shoqerise

17.1 Asambleja e Pergjithshme do te marre vendimin mbi shperndarjen e fitimit vjetor, ne perputhje me perqindjen e kuotave te zoteruara.

17.2 Ortaket pranojne dhe marrin persiper te mos kerkojne shperndarjen e fitimit gjate 5 (pese) viteve te aktivitetit te Shoqerise, afat qe fillon nga nenshkrimi i ketij Statuti.

17.3 Ortake pranojne se fitimi sipas paragrafit paraardhes do te perdoret per tu ri-investuar ne Shoqeri ne menyre qe te maksimizohet fitimi.

17.4 Ortaket nuk do te terheqin fonde nga aktiviteti i Shoqerise, pervec me ratin e shperndarjes se fitimit vjetor ne trajten e dividendit. Ne rast se ndonjeri nga Ortaket do te kete nevojën te kryejne nje terheqje te parakohshme nga fondet e Shoqerise, ai do te marre paraprakisht miratimin e Ortakeve te tjere. Pjesa e terhequr paraprakisht do te zbritet nga shuma qe i takon Ortakut sipas shperndarjes vjetore te fitimit.

17.5 Ne rast se ortaku ka terhequr nje vlere me te madhe se dividenti qe i takonte sipas shperndarjes vjetore, atehere kjo shume te konsiderohet si nje detyrim i ortakut kundrejt shoqerise. Ky detyrim duhet te shlyhet brenda 3 muajve nga data e shperndarjes se dividendit. Nese ky afat nuk respektohet nga ortaku, do te aplikohen kamatevonesat ligjore te cilat fillojne nga dita e fundit e afatit te pageses si me siper si dhe shuma se bashku me kamatevonesat do te zbritet nga dividenti i ardhshem qe do te shperndajë Shoqeria per ate ortak.

## SHPERBERJA DHE LIKUIDIMI

## Neni 18

## Shperberja dhe Likuidimi

18.1 Kompania do te mbyllet dhe likuidohet ne rastet e meposhtme:

- a. me vendim te Asamblese se Pergjithshme;
- b. nga bashkimi me nje tjetër Shoqeri;
- c. me vendim gjykate te juridiksionit perkates, ne çdo rast te parashikuar ne Ligj;
- d. ne raste te tjera te parashikuara me Ligj.

18.2 Likuidimi i Shoqerise dhe shperndarja e asetëve te saj do te behet ne perputhje me dispozitat ligjore perkatese te ligjit mbi shoqerite tregtare ne fuqi.

## DISPOZITAT PER FUNDIMTARE

## Neni 19

## Mosmarreshjet dhe Gjykata kompetente

19.1 Ne rast te mosmarreshjeve qe lindin ne lidhje me kete Statut ose per shkak te ligjit, keto mosmarreshje do te zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

19.2 Ligji i aplikueshem do te jete ligji i Republikes se Shqiperise.

\*\*\*

Nenshkruar me, 12 /04/2022 ne 3 kopje origjinale ne gjuhen Shqipe.



BARDHI KUTZI

*[Handwritten signature]*

Redjon Stase *[Handwritten signature]*

MARK TATE S'

*[Handwritten signature]*